



PRELATORIA 01370
Ardit
Nr. 14 dt. 06.01.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 438/1 prot.

Peshkopi, më 29.12.2021

VENDIM

Nr. 15 Date 29.12.2021

PËR

MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR PËR VITIN 2022

Mbështetur në, Ligjin nr.139/2015, dt 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, neni 77 pika "ç", ligji nr 7961, datë 12.07.1995 " Kodi i Punës si Republikës së Shqipërisë" me ndryshime, ligji nr 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, VKM nr 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", VKM nr 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punësnë institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", VKM nr 177, dt 08.03.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" Këshilli i Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 29.12.2021 me kërkesë të sektorit juridik dhe të projekteve, pasi shqyrtoj Vendimin e Kryesisë "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër për vitin 2022, me 10 (dhjetë) vota pro,

VENDOSI:

- 1- Të miratoj strukturën organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër për vitin 2022, emërtimet e drejtorisë, sektorve dhe pozicionet e punës, klasifikimin e pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil si dhe nivelin e pagës për çdo pozicion, sipas tabelave 1 dhe 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
- 2-Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Sektori Juridik
- 3-Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.
- 4-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
- 5-U shpall me dt.29.12.2021.

KRYETAR

Valentina Haliti



Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al